



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.517/2023
Datë: 27 nëntor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.4, 1.12, 1.17, nenit 30 paragrafi 3, 6 dhe 8 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 15 dhe 35 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, Rregullore Nr.12/2022 Për Procedurën e Zgjedhjes, Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës në takimin 317-të, të mbajtur më 27 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Znj. Suzana Cerkini emërohet gjyqtare mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore Prishtinë dega Fushë Kosovë.
- II. Mandati i znj. Cerkini si gjyqtare mbikëqyrëse është pesë (5) vjeçar, dhe do të filloj nga data 1 janar 2024.
- III. Znj. Cerkini, të vazhdoj trajtimin e lëndëve ku është kryetare e kolegjit edhe pas datës 1 janar 2024, nëse ato nuk përfundojnë ndërsa kryetarja e gjykatës të njoftoj KGJK-në me listën e lëndëve ku mbetet e angazhuar gjyqtarja.
- IV. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 nëntor 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.291/2023, të datës 28 korrik 2023, ka rishpallur konkurs për pozitën gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore Prishtinë – dega Fushë Kosovë. Komisioni Vlerësues për Intervistimin, Vlerësimin dhe Rekomandimin e kandidatëve për pozitën gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore Prishtinë – dega Fushë Kosovë, i ka rekomanduar KGJK-së dy (2) kandidat.

Këshilli, në takimin e mbajtur më 27 nëntor 2023, pas shqyrtimit të rekomandimit të komisionit, me votim të fshehtë dhe shumicë të votave, për zgjedhi dhe emëroi znj. Suzana Cerkini gjyqtare mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore Prishtinë – dega Fushë Kosovë.

Nga se u tha si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Znj. Suzana Cerkini, gjyqtare mbikëqyrëse në Gjykatën Themelore Prishtinë dega Fushë Kosovë;
- Znj. Albina Shabani Rama, kryetare e Gjykatës Themelore Prishtinë;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe Arkivit.